

Fred Hutchinson Cancer Research Center  
University of Washington

**Formular Aprovimi i Shkurtër për të marrë Pjesë në një Studim Kërkimor**

Numri i Protokollit: \_\_\_\_\_

Emri i Hetuesit Kryesor: \_\_\_\_\_

*Nëse po shërbeni si përfaqësues, kujdestar i autorizuar me ligj apo po jepni lejen prindërore për një fëmijë në këtë studim, termat "ju" dhe "juaj" i referohen personit për të cilin po jepni aprovimin ose lejen prindërore.*

**Po ju kërkohet të merrni pjesë në një studim kërkimor**

Duhet të merrni kohën që ju duhet për të vendosur nëse doni të futeni në këtë studim. Duhet ta diskutoni vendimin me familjen dhe miqtë.

Para se të pranoni të merrni pjesë, ne do t'ju shpjegojmë:

1. Pse po bëhet studimi;
2. Çfarë do të ndodhë gjatë studimit dhe të gjitha procedurat që janë eksperimentale;
3. Rreziqet që mund të parashikohen dhe dobitë e futjes në studim;
4. Alternativa të tjera të futjes në studim dhe rreziqet e dobitë e tyre;
5. Si do të mbrohet privatësia dhe konfidencialiteti juaj;
6. Me kë të kontaktoni për pyetje.

Kur të jetë e zbatueshme, ne do t'ju shpjegojmë:

1. Kush paguan për trajtimin nëse lëndoheni gjatë studimit;
2. Mundësinë e rreziqeve që nuk i dimë akoma;
3. Pse mund të hiqeni nga studimi;
4. Çdo kosto të pjesëmarrjes në studim;
5. Çfarë ndodh nëse vendosni ta lini studimin;
6. Kur do të mësoni për zbulimet e reja në lidhje me studimin;
7. Sa njerëz janë planifikuar për studimin;
8. Çdo studim me dëshirë ku mund të merrni pjesë.

Një përshkrim i këtij studimi klinik do të jetë në dispozicion në [www.clinicaltrials.gov](http://www.clinicaltrials.gov), siç kërkohet nga ligji në SHBA. Kjo faqe interneti nuk do të përfshijë informacione që mund t'ju identifikojnë juve. Më së shumti, faqja e internetit do të ketë një përmbledhje të rezultateve. Mund të kërkoni në këtë faqe interneti në çdo kohë.

Fred Hutchinson Cancer Research Center  
University of Washington

**Formular Aprovimi i Shkurtër për të marrë Pjesë në një Studim Kërkimor**

**Të drejtat tuaja**

Nuk jeni të detyruar të merrni pjesë në këtë studim. Jeni të lirë të thoni po ose jo. Nëse futeni në këtë studim, nuk jeni të detyruar të qëndroni në të. Mund të ndaloni në çdo kohë (madje edhe para se të filloni). Nuk ka asnjë gjobë për thënien jo ose ndalimin. Kujdesi juaj mjekësor i zakonshëm nuk do të ndryshojë.

Nëse sëmureni ose lëndoheni gjatë studimit, nuk humbisni asnjë prej të drejtave tuaja ligjore për të kërkuar pagesë nga firmosja e këtij formulari.

Nëse pranoni të futeni, do të merrni një kopje të këtij formulari dhe një kopje të formularit të aprovimit në anglisht për studimin.

**Për më shumë informacion**

Mund të kontaktoni hetuesin kryesor \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ çdo herë që keni pyetje rreth studimit apo një lëndimi që lidhet me studimin.

Gjithashtu mund të kontaktoni Karen Hansen, Drejtor i Zyrës të Shqyrtimit Institucional, Fred Hutchinson Cancer Research Center në 206-667-4867 nëse keni pyetje rreth të drejtave tuaja si subjekt i studimit ose çfarë të bëni nëse lëndoheni.

**Firma**

Nëse e firmosni këtë formular, kjo do të thotë që ne ua kemi rekomanduar studimin juve, dhe ju pranoni të merrni pjesë me dëshirë.

\_\_\_\_\_  
Emri i Shtypur i Pjesëmarrësit dhe Firma  
Ose Përfaqësuesi Ligjor i Autorizuar, nëse zbatohet

\_\_\_\_\_  
Data

\_\_\_\_\_  
Marrëdhënia e Përfaqësuesit Ligjor të Autorizuar me Pjesëmarrësin, nëse zbatohet

\_\_\_\_\_  
Emri i Shtypur i Përkthyesit/Dëshmitarit dhe Firma

\_\_\_\_\_  
Data